

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
NOTERE GENTJANA A. DEDJA

Taksa e pullës u aplikua ne kopjen
e parë që arkivohet ne noteri

NR 2533 REP NR 1334 KOL

KONTRATË

SHITBLERJE KUOTASH

Sot me datën 25 / 09 /2018 (shtator, dymije e tetembehjete), para meje noteres Gentjana A. Dedja, anëtare e dhomës së noterëve Tiranë, Rrethi Gjygjësor Tiranë ,Rruga Skender Luarasi, Nr 19, u paraqitën personalisht palët kontraktuese :


S H I T E S I: SHOQERIA “V & A ENERGJI KLOS” Shpk në selinë e Shoqerise “V & A ENERGJI KLOS” Shpk me seli ne Diber Klos Bashkia Klos Bashkia Klos, Pallati Nr.1, Ap.3, Rrethi Mat, Qarku Diber, regjistruar ne QKB, Dt 29/09/2011 me NIPT .L18329901O, e cila për efekt të kësaj Kontrate do të quhet shitesi, ne cilesine e ortakes e cila zoteron 70% te kuotave te kapitalit themeltar ne Shoqerine “IRARBA ENERGJI” Shpk , me adminisrator **Rigert Kaçi** atesia Dalip, lindur ne Klos, Mat me 16.10.1986, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar pajisur me Nr personal I61016007O, perfaqesuar me prokure te posaçme Nr 504 Rep, Nr 210 Kol date 14.04.2018, redaktuar nga Notere Vjollca Skendo Tirane, me perfaqesues te posaçem perfaqesuesi Bedri Hoxha, atesia Selman, lindur ne Guri i Bardhe, me 07.04.1968, banues ne Klos, Mat, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar identitet te cilin e kam te sigurte nga leternjoftimi Nr personal G80407005J.

B L E R E S I: SHOQËRIA “MARA 2011” Shpk ne cilesine e Ortakes e cila zoteron 30% te kuotave te kapitalit themeltar ne Shoqerine “IRARBA ENERGJI” Shpk me seli ne Diber Burrel Burrel Lagjja "Pjetër Budi", pallati prane Bashkisë Burrel, e regjistruar ne QKB dt 16/11/2011, me NIPT. L18516901B perfaqesuar nga Administratori dhe ortakut i vetem i kesaj shoqerie **Bruno Mara**, atesia Xhavit, lindur ne Baze, Mat, më 01.05.1980,banues ne Tiranë, madhor me zotësi te plotë juridike dhe për të vepruar, shtetas shqiptar, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi, Nr personal I00501110S, i cili për efekt të kësaj Kontrate do të quhet bleresi:

Në vijim dhe për efekt të kësaj Kontrate, të dy së bashku do të referohen si “Palët” dhe veç e veç si “Pala”. Te lartpermendurit me deshiren dhe me vullnetin e tyre te lire dhe te plote me kerkuan redaktimin e ketij akti si me poshte vijon:

BAZA LIGJORE

Në përputhje me nenet 705 vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenin 73 pika 1/ç, të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, si dhe vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.



OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj Kontrate shitje, është transferimi nëpërmjet shitjes nga Pala shitese Shoqëria “V & A ENERGJI KLOS” Shpk tek pala blerese Shoqëria “MARA 2011” Shpk.

- Sipas Vendim te Asamblese se ortakeve ne seline e Shoqerise “V & A ENERGJI KLOS” Shpk ” shpk
- Sipas Vendim te Asamblese se ortakeve ne seline e Shoqerise “MARA 2011” Shpk eshte vendosur:

“Shoqëria “V & A ENERGJI KLOS” Shpk, e cila zotëron 70% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqërisë “IRARBA ENERGJI ” shpk, ti shesë 20% te kuotave te kapitalit të saj themeltar, shoqerise “MARA 2011” Shpk e cila aktualisht zoteron 30% te kuotave te kapitalit themeltar në shoqërinë “IRARBA ENERGJI ” shpk.

MENYRA E KALIMIT DHE LIKUJDIMIT

Pala shitese “V & A ENERGJI KLOS” Shpk, deklaron se eshte dakort ti shese 20 % , te kuotave te kapitalit themeltar që ka kjo shoqëri në shoqërinë “**IRARBA ENERGJI” Shpk**, ne vleren 20000 Leke (njezet mije leke), pales blerese shoqerise “MARA 2011” shpk, e cila aktualisht zoteron **30%** te kuotave te kapitalit themeltar në shoqërinë “**IRARBA ENERGJI ”** shpk.

Bleresi shoqëria “MARA 2011” shpk , e cila eshte nje nga Ortaket e Shoqerise “**IRARBA ENERGJI” Shpk** , pranon blerjen e 20% pjesë të kuotës së kapitalit **ne vleren 20000 Leke (njezet mije leke)**. Pala blerese deklaron se ka paguar jashte kesaj zyre noteriale ne favor te shitesve shumen perkatese, dhe nuk ka asnje pretendim. Shitesit deklarojne se jane likujduar nga bleresi ne shumen e lartpermendur .

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit Shoqëria “IRARBA ENERGJI” shpk do te kete dy ortake me perqindje si vijon :

“Shoqerine “Mara 2011” shpk me 50 % te kuotave pjesemarrese dhe “ V&A Energji Klos” shpk me 50 % te kuotave pjesemarrese.

SHTOJCAT E KONTRATËS

Kësaj Kontrate shitje Kuotash, i bashkëngjiten dhe janë pjesë përbërëse e saj:

- Ekstrakti mbi të dhënat e regjistrimit të shoqërisë .
- Dokumentet e identifikimit te paleve kontraktuese.
- Vendimet e Asamblesë së Ortakeve.
- Prokure e posaçme.



Palëve iu lexua kontrata , iu shpjegua, u kuptua dhe iu bënë te ditura pasojat ligjore ,dhe pasi e gjetën aktin te redaktuar sipas vullnetit te tyre te lirë dhe te plotë,e nënshkruan atë pa vërejtje në praninë time.

Ky akt u redaktua nga unë notere **Gentjana A. Dedja** ne kater origjinale te njëjta , ne gjuhën shqipe ,ne baze te nenit 51 të ligjit Nr 7829 dt 01.06.1994 “Për noterinë”nga te cilat njera qendron prane kesaj zyre, nga nje kopje iu jepet paleve kontraktuese dhe njera dergohet ne QKB per te ndryshimet e duhura. Ne baze neni 39 të ligjitNr 7829 dt 01.06.1994 “Për noterinë” vërtetoj nënshkrimin e tyre.


PALËT KONTRAKTUESE

SHIITESI

SHOQERIA “V & A ENERGJI KLOS” Shpk

Me administrator Z. Rigert Kaçi

Perfaqesuar nga Bedri Hoxha



V & A
ENERGY
KLOS

BLERESI

SHOQERIA “MARA 2011 ” Shpk

Me administrator Z. Bruno Mara




NOTERE

GENTJANA A. DEDJA




VENDIMI I ORTAKEVE TE

Shoqëria "V & A ENERGJI KLOS" Shpk

Sot, më datë 25.09 .2018 në selinë e Shoqërisë "V & A ENERGJI KLOS" Shpk me seli në Diber Klos Bashkia Klos Bashkia Klos, Pallati Nr.1, Ap.3, Rrethi Mat, Qarku Diber, regjistruar në QKB, Dt 29/09/2011 me NIPT .L18329901O në ortaket e kësaj shoqërie Sami Rami, Bedri Hoxha, Rigert Kaçi i perfaqësuar me prokurë të posaçme Nr 504 Rep, Nr 210 Kol date 14.04.2018, redaktuar nga Notere Vjollca Skendo Tirane, nga Bedri Hoxha, pasi shqyrtuam :

Rendin e Ditës:

- Transferimi nepermjet shitjes para çdo zyre noteriale, nga Shoqëria "V & A ENERGJI KLOS" Shpk, zoteruese me 70 % pjese te kuotave te kapitalit, qe shoqëria zoteron ne Shoqërine " Irarba Energji" shpk, nga te cilat 20% pjesë të kuotave të kapitalit t'i shiten shoqërisë "MARA 2011" shpk e cila është bashkeortake ne Shoqërine " Irarba Energji" shpk.
- Z. Sami Rami te shese 6 % te kuotave pjesemarrese, Z. Bedri Hoxha te shese 6 % te kuotave pjesemarrese, Z. Rigert Kaçi 8 % te kuotave pjesemarrese.
- Ne ortaket pasi shqyrtuam rendin e dites si dhe,

Në përputhje me nenin 73 të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" që parashikon se "1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:...ç) dhurimit.", dhe nenet 761-771 të Kodit Civil,

VENDOSEM:

- Transferimi nepermjet shitjes nga Shoqëria "V & A ENERGJI KLOS" Shpk, zoteruese me 70 % pjese te kuotave te kapitalit, qe shoqëria zoteron ne Shoqërine " Irarba Energji" shpk, nga te cilat 20% pjesë të kuotave të kapitalit t'i shiten shoqërisë "MARA 2011" shpk regjistruar ne QKB me NIPT. L18516901B, e cila është bashkeortake ne Shoqërine " Irarba Energji" shpk.
- Z. Bedri Hoxha, mbajtës i leternjofimit Nr G80407005J, në emër dhe për llogari të shoqërisë, të kryejë të gjitha veprimet për depozitimin dhe regjistrimin e këtij vendimi dhe të kontratës për transferimin nëpërmjet shitjes të kuotave së kapitalit të shoqërisë, që do të lidhet me shoqërine "MARA 2011" Shpk", në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

ORTAKET E SHOQËRISË

"V & A ENERGJI KLOS" Shpk

Z. SAMI RAMI

Z. RIGERT KAÇI

Perfaqësuar nga Bedri Hoxha

BEDRI HOXHA

V & A
ENERGY
KLOS

VENDIM I ORTAKUT TE VETEM

te Shoqerise "MARA 2011" Shpk

Sot, më datë 25 / 09 /2018 në selinë e Shoqerise seli ne Diber Burrel BURREL Lagjja "Pjetër Budi", pallati prane Bashkisë Burrel, e regjistruar ne QKB dt 16/11/2011, me NIPT. L18516901B, une ortaku i vetem i shoqerise Z. Bruno Mara pasi shqyrtova :

Rendin e Ditës:

- Shoqeria "MARA 2011" shpk, t'i bleje 20% pjese te kuotave, Shoqerise " V & A Energji Klos " Shpk e cila zoteron 70 % te kuotave ne Shoqerine **Irarba Energji" shpk.**

Une ortaku pasi shqyrtova rendin e dites si dhe,

Në përputhje me nenin 73 të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" që parashikon se "1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:...ç) dhurimit.", dhe nenet 761-771 të Kodit Civil,

VENDOSA


- Shoqeria "MARA 2011" shpk, t'i bleje 20% pjese te kuotave, Shoqerise " V & A Energji Klos " Shpk e cila zoteron 70 % te kuotave ne Shoqerine **Irarba Energji" shpk.**

SHOQËRIA " MARA 2011 " SHPK

ORTAKU I VETEM

BRUNO MARA



BRUNO MARA


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERVE TIRANE
NOTERE VJOLLCA SKENDO
ZYRA NOTARIALE

Nr 504 Rep
Nr 210 Kol

taksa u likujdua

PROKURE E POSACME

Ne Tirane sot date 14 prill 2018 (dymije e tetembedhete), ditën e shtunë ne zyren e noterise me seli ne rrugen Bajram Curri perpara meje noteres Vjollca Skendo u paraqit personalisht :

RIGERT KACI e bija e Dalip, dtl 16.10.1986, lindur ne Bejne, Burrel, dhe banues ne Tirane rruga Ndre Mjeda, pall i ri nr 3, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar me identitetin e te cilit u garantova me karten e identitetit nr I610160070.

I cili me vullnet te lire dhe te plote me kerkuan redaktimin e kesaj prokure te posaçme si me poshte vijon:

Une i perfaqesuari Rigert Kaci jam ortak ne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "V&A ENERGI KLOS", shpk, me nr NIPT-i L 183299010, ne kete shoqeri une kam detyren e administratorit dhe zoterorj 14.28% te kuotave te kapitalit themeltar.

Shoqeria "V&A ENERGI KLOS", shpk, eshte orake ne shoqerine "IRARBA ENERGI", shpk me nr NIPT-i L38402901A. Ne kete shoqeri, shoqeria "V&A ENERGI KLOS", shpk, zoteron 70% te kuotave te kapitalit themeltar.

Emerorj si perfaqesues te posaçem zotin **BEDRI HOXHA** i biri i Selman, dtl 07.04.1968, lindur ne Gur i Bardhe, mepasaporte me nr personal G80407005J te cilit i jap te drejte dhe kompetence qe ne emer dhe per llogarine time, te kryeje keto veprime:

-Te me perfaqesojë mua ne te gjithë vendimet e asamblese se ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "V&A ENERGI KLOS", shpk, me nr NIPT-i L 183299010. Te nenshkruaje vete keto vendime qofte edhe perpara noterit. Te me perfaqesojë mua si administrator perpara organeve tatimore, dogana, organeve te pushtetit lokal e qendror pa asnje kufizim, prane Ministive, ku ka te drejte te jape spjegime te paraqese kerkesa, ankesa te kerkoje apo depozitoje dokumentacionin e nevojshem, te asistojë ne kryerjen e kontrolleve nga keto organe, te nenshkruaje e plotesojë vete deklarimet tatimore te shoqerise.

-Shoqeria "IRARBA ENERGI", shpk me nr NIPT-i L38402901A do te marre kredi bankare prane nje banke te nivelit te dyte qe operon ne Republiken e Shqiperise. I autorizuari prej meje Bedri Hoxha ka te drejte te nenshkruaje vendimet e asamblese se ortakeve te shoqerise "V&A ENERGI KLOS", shpk e cila eshte ortak e shoqerise IRARBA ENERGI, shpk, te percaktojë vete shumen qe do te bihet dakort per tu marre kredia, llojin e kredise, bankare, kredi me kufi etj, banken ne te cilen do te merret kredia etj. Te nenshkruaje ne emer dhe per llogarine time vendimet e asamblese se ortakeve edhe perpara noterit qofshin keto vendime te shoqerise shoqerise "V&A ENERGI KLOS", shpk apo vendimet e Shoqerise "IRARBA ENERGI", shpk duke percaktuar vete permbajtjen e vendimeve pa asnje kufizim qellimi i te cilave te jete marrja e kredise bankare nga ana e shoqerise "IRARBA ENERGI", shpk.

Kjo prokure eshte e vlefshme per nje vit kohe duke i filluar efektet e saj sot date 14 prill 2018, ne rast revokimi perpara afatit nga ana ime, ky revokim do te behet ne rruge ligjore perpara noterit vetem ne Republiken e Shqiperise, dhe nje kopje e tij do ti behet e ditur me shkrim perfaqesuesit. Prokuren e mesiperme si e lexova dhe pashe se eshte ne perputhje te plote me deshiren dhe vullnetin tim te lire dhe te plote e nenshkruaj pa verejtje ne prani te noteres. "

Prokura e mesiperme u redaktua nga une noterja Vjollca Skendo bazuar ne ligj dhe konkretisht 64 e vijues te K.Civil dhe ne ligjin nr 7928 date 01.06.1994 "Per Noterine", deshiren dhe vullnetin e lire te te perfaqesuarit, ndaj e vertetoj ate.

I PERFAQESUARI

Rigert Kaci

NOTERE

Vjollca Skendo